

VENDIM
Nr.584, datë 7.9.2022

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.187, DATË 8.3.2017,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË
NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE CIVILË/NËPUNËSVE,
ZËVENDËSMINISTRIT DHE NËPUNËSVE TË KABINETEVE NË DISA
INSTITUCIONE TË ADMINISTRATËS PUBLIKE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr.10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, strukturat dhe shpërblimet e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.187, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në pikën 1/3 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

i. Në shkronjën “a” shtohen emërtesat “Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit”, “Agjencia Kombëtare e Mjedisit” dhe “Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura”;

ii. Në shkronjën “b”, emërtesat “Drejtoria e Akreditimit”, “Agjencia Kombëtare e Mjedisit” dhe “Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura” shfuqizohen.

b) Pas pikës 4/20 shtohet pika 4/21, me këtë përmbajtje:

“4/21. Në Drejtorinë e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, “titullari i institucionit” dhe nëpunësit në njësitë teknike të përmbajtjes, në masën 20 000 (njëzet mijë) lekë në muaj.”.

c) Në pikën 6, pas paragrafit, që përcakton pagesat për këshilltarët e jashtëm dhe ndihmësit e jashtëm të Kryeministrit, shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Përfundimisht, Kryeministri ka të drejtë të angazhojë si këshilltarë të jashtëm edhe shtetas të huaj, ekspertë/konsulentë të njohur ndërkombëtarisht, me një pagesë jo më shumë sesa 1 000 000 (një milion) lekë në muaj, për një periudhë angazhimi jo më shumë se sa kohëzgjatja e mandatit të tij.”.

ç) Në rreshtin e tretë të lidhjes nr.6, pas emërtesës “Drejtor drejtorie në drejtoritë e përmbajtjes në Agjencinë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit” shtohen emërtesat “Drejtor drejtorie në drejtoritë e përmbajtjes në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, në nivel qendror” dhe “Drejtor drejtorie në drejtoritë e përmbajtjes në Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura.”.

d) Në lidhjen nr.9, përpara rreshtit

Titullar i institucionit rajonal.	III-b	1
-----------------------------------	-------	---

shtohet rreshti, me këtë përmbajtje:

Titullar i agjencie rajonale të mjedisit.	III-a/1	1
---	---------	---

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi për vitin 2022, për:

a) Kryeministrinë dhe Drejtorinë e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar të përballohen nga fondet e miratuara për secilin institucion për këtë vit dhe të fillojnë pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi;

b) të gjitha parashikimet e tjera të përballohen nga fondet e miratuara për këtë vit për secilin institucion dhe të fillojnë në momentin e emërimit apo transferimit të nëpunësve në strukturat dhe organikat e reja.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama